



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Emmanuel Delphin Assako Ella** më datë 03.07.2024 ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: Ndryshimin e masës sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arrest në burg”, duke caktuar një masë sigurimi personal me karakter shtrëngues më të lehtë, atë për “Detyrim paraqitje”.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Flora Hajredinaj, bazuar në nenet 228, 229, 230, 232, 234, 407, 410, 412, 413, 415, 422, 424, 428 e vijues të K.Pr.Penale, me vendimin Nr. 419, datë 16.07.2024, vendosi:

1. Rrëzimin e kërkesës së kërkuesit **Emmanuel Delphin Assako Ella** për zëvendësimin e masës së sigurimit të regjistruar me nr.419, datë 03.07.2024, të masës së sigurimit “arrest në burg”, të caktuar me vendimin nr.37, datë 10.04.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar, me një masë sigurimi më të butë si të pabazuar në ligj dhe në prova.
2. Shqyrtimin në seancë gjyqësore të informacionit me shkrim, të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korruptionit dhe Krimit të Organizuar, në lidhje me hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit për të arrestuarin në burg Emmanuel Delphin Assako Ella, dhe vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit “**arrest në burg**” për të hetuarin **Emmanuel Delphin Assako Ella**, të caktuar me vendimin nr.37, datë 10.04.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar.
3. Shpërblimin e përkthyeses Rezarda Myderizi sipas rregullave financiare.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi brenda 5(pesë) ditëve duke filluar nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar në Gjykatën e Posaçme të Apelit, për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar.

Tiranë, më datë 16.07.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar